

# TË GJITHË SË BASHKU



# PËR DEMOKRACINË

# KUVENDI I KOSOVËS

LISA (10), OLSA (10), LEONI (10), ENDI (10), ZANA (10), LORINA (10), LIR (10), ELION (10)



## Funksionet kryesore të Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, ku 20 prej tyre janë komunitete jo shumicë. Deputetët zgjedhen nga votat e qytetarëve.

Ne kemi të drejtë të marrim pjesë në procesin zgjedhor mbi moshën 18 vjeçare. Në Kuvend organizohen seanca ku miratohen ligjet, miratohet buxheti i vendit, etj. Kuvendi mbikëqyrë qeverinë. Në kuvend zgjidhen problemet politike dhe problemet e ndryshme të popullit. Deputetët kanë 4 vjet mandat, kurse Presidenti 5 vjet. Në seancat plenare janë drejtuesit e Qeverisë dhe deputetët. Kuvendi është pushteti legjislativ, sepse miratohet ligjet. Kuvendi përfaqëson popullin dhe kërkesat e popullit. Deputetët duhet të jenë të mençur, të drejtë dhe punëtorë. Kuvendi funksionon sipas Kushtetutës

dhe në Kushtetutë ka nene se si duhet të sillen deputetët.

Kuvendi nuk duhet të dalloj qytetarët nga raca, gjinia, feja dhe në përgjithësi duhet t'i trajtojë të gjithë të barabartë. Të drejtën për të paraqitur projektligje kanë: Qeveria, deputetët, Presidenti dhe më së paku 10.000 qytetarë, pastaj këto projektligje duhet të votohen nga deputetët. Në Kuvend, ka edhe komisione të ndryshme, si për shembull Komisioni për Arsim, për Bujqësi, Infrastrukturë, Shëndetësi etj. Ne nxënësit e klasës së V-të të shkollës Faik Konica kemi mësuar se, Kuvendi merr vendime për popullin, prandaj edhe në të ardhmen kur do të votojmë, do t'i zgjedhim më të mirët që do të na plotësojnë kushtet e kërkuara. Pra, Kuvendi është shtëpia e të gjithë popullit.





# DEMOKRACIA ËSHTË LIRIA

SHARR (10), LIS (9), REA (10), RINA (10), DALINA (10), LUIS (10), YLLI (10)

## Demokracia është e ardhmja jonë

Demokracia filloi në vitin 507 p.e.s.

Tani falë demokracisë ne kemi të drejtën e votës, të jetesës, shkollimit, punësimit, etj. Më herët gratë nuk lejoheshin të punonin. Në demokraci të gjithë jemi të barabartë, si gjinia mashkullore ashtu edhe gjinia femërore.



Tani që ekziston demokracia kemi të gjitha kushtet dhe të drejtat e nevojshme. Ne si fëmijë kemi të drejtë të shkollohemi, kemi të drejtën e lojës, të drejtën e pushimit, etj.

Fjala demokraci rrjedh nga fjalët „demos“ që do të thotë popull, kurse „kratia“ do të thotë pushtet.

Edhe në demokraci ka mos pajtime që shprehen me protesta paqësore. Ne sot mësuam se fjala jonë ka shumë vlerë në një shtet demokratik.





Autorët e artikullit



E drejta e krijimit të familjes

E drejta e votës



E drejta e jetesës

E drejta e shkollimit

## FËMIJËT NË ZGJEDHJE

ARTI (10), BLERZA (10), FIONA (10), STINA (10), OLTİ (10), MERISI (10), RRONI (10)

### Zgjedhjet janë zemra e demokracisë

Zgjedhjet janë të pranishme pothuajse në çdo hap që ne e bëjmë, si për shembull kur kemi një dilemë dhe mbase duhet të zgjedhim se e cila mundësi është me e mira dhe që mund ta bëjmë.

Zgjedhjet na duhen për të zgjedhur udhëheqësin e vendit, dhe që udhëheqësi të na ndihmojë dhe ta bëjë më të mirën për shtetin. Pa zgjedhje bota do kishte konflikte se kush do ishte i pari i shtetit apo i qytetit. Ne si fëmijë sot mësuam më shumë rreth zgjedhjeve, çka janë dhe se si funksionojnë. Sot të gjithë ne kandiduam dhe gjithsej ishim 7 parti por „Partia Dardha“ doli të jetë fituese e këtyre zgjedhjeve. Ne votuam „Partinë Dardha“ për arsye se programi i saj na ofronte shumë mundësi të mira për ne si fëmijë.



Njëra nga kandidatet duke shkruar programin e saj




Partia Dardha, Dredhëza dhe Molla



Partia Pjeshka, Frutat e Pyllit, Avokado dhe Frutat e Malit



Partitë në balotazh




Partia fituese është Partia Dardha



# QYTETARË TË PËRGJEGJSHËM

ANDA (10), KRONI (10), HARFA (10), LIRI (10), YLLKA (10), YLL JON (10), OLSA (10)



## Fëmijët e shohin Kosovën të qytetëruar

Qytetarë janë të gjithë personat që jetojnë në Kosovë, të cilët kanë të drejta të barabarta të përcaktuara me ligj. Të gjithë qytetarët kanë të drejta, por edhe përgjegjësi. Disa nga të drejtat e qytetarëve janë: e drejta e banimit, e drejta e arsimit, e drejta e argëtimit, e drejta e lëvizjes, e drejta e familjes, e drejta e profesionit, etj. Tani kalojmë tek përgjegjësitë e qytetarëve: respektimi i rregullave dhe ligjeve, respektimi i rregullave në familje, kujdesi i ambientit, kujdesi për njerëz në raste të veçanta. Qytetarët të cilët nuk respektojnë rregullat dhe ligjet duhet të ndalojnë, sepse ata po lëndojnë vetëveten por dhe neve. Qytetarë quhen ata që jetojnë, rriten, mësojnë në Kosovë ose në shtete të tjera. Të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë respektojnë

rregullat dhe përgjegjësitë e tyre. Qytetarët e Kosovës duhet dhe janë të përgjegjshëm ndaj shtetit të tyre. Të gjithë Kosovën e kanë punuar dhe ndërtuar kosovarët. Kosova çdo ditë po ecën më tutje me ndihmën e qytetarëve aktiv.



Vetëm të bashkuar shkojmë përpara



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Faik Konica“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-4  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë